



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODER

Nr. 625/1 prot.

Nr. 5024/1 Prot
Dt. 11.10.22

Shkodër, më 7.10.2022

Lënda: Mbi Vendimin nr. 54, datë 23.09.2022 të Këshillit Bashkiak Vau Dejës

KËSHILLI BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 8, shkronja "a", të Urdhërit të Kryeministrit nr. 50, datë 12.04.2017 "Për miratimin e detyrave të administratës së Prefektit të Qarkut", të Urdhërit të MB nr. 175, datë 09.07.2020 "Për miratimin e rregullores së brendshme "Për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut", si dhe aneksin I, "Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut", të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, neni 29, neni 54, shkronja "dh", neni 55, pika 3, neni 64, shkronja "c", të ligjit nr. 45/2019 "Për mbrojtjen civile" neni 30/gj, neni 41/2, 65, VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës ekonomike shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", Kreu III, të VKB Vau Dejës nr. 72, datë 23.12.2021 "Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022 dhe Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024 të Bashkisë Vau Dejës", të shkresës së Këshillit Bashkiak Vau Dejës nr. 5022 prot., datë 28.09.2022 "Dokumentacioni i mbledhjes së Këshillit Bashkiak Vau Dejës, të datës 23.09.2022", shqyrtoi **VKB Vau Dejës Nr. 54, datë 23.09.2022 "Për dhënie ndihmë financiare familjes së z. Jak Cara që është i dëmtuar banesa si pasojë e zjarrit të rënë, sipas Vërtetimit të MZSH nr. 8, datë 24.08.2022"**, me ndihmë financiare z. Jak Cara në shumën prej 879.170 lekë, nga programi 3280 "Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile", nga buxheti i vitit 2022 të Bashkisë Vau Dejës.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon procedimin.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

P R E F E K T I

Majlinda ANGONI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK

V E N D I M

Nr. 54 datë 23.09.2022

Dhënie ndihme financiare familjes së z.Jak Pjeter Cara që i është dëmtuar banesa si pasoje e zjarrit të rene me dt.19.08.2022

Bazueshmëria ligjore e vendimit të propozuar është:

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar,Ligjit Nr.45/2019 “Për mbrojtjen civile”, VKM-së Nr.329 datë 16.05.2012 “Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të shkaktuara nga veprimtaria njerezore”, Udhëzimi nr.3 dt.28.12.2016 “Për miratimin e kostos së ndërtimit të banesave nga enti kombëtar i banesave , për vitin 2016, si dhe në shkresën Nr.373/1 dt.17.05.2016 të Prefekturës së Qarkut Shkodër “Në lidhje me çmimet e mobiljeve, orendive dhe pajisjeve elektroshtëpiake të dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”si dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr.72 dt.23.12.2021 “Mbi miratimin e Buxhetit të Vitit 2022”konfirmuar nga Prefektura Shkoder me shkresën Nr.12/1 dt.14.01.2022,si dhe pas shqyrtimit te projekt vendimit Nr.4 dt.15.09.2022, paraqitur nga Sektori i Emergjencave Civile , ku propozohet dhënia e ndihmës financiare për shtetasin **Jak Cara** banorë i **qytetit Vau-Dejes** të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës:

Pas diskutimit dhe miratimit me shumice të cilësuar votash,

KËSHILLI BASHKIAK
V E N D O S I:

- 1. Miratimin** e proces verbalit të konstatimit të gjendjes dhe dokumentacionit të vlerësimit të dëmeve, të hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e kryetarit te Bashkisë Nr.341 prot dt.30.08.2022 në vlerën totalë **1.758.340** leke(Njëmilion e shtatëqind e pesëdhjetë e tetë mijë e treqind e katërdhjetë) lekë për shtetasin **Jak Pjeter Cara** banorë i Qytetit Vau-Dejes të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës .
- 2. Miratimin** e dhënies së ndihmës financiare për shtetasin **Jak Cara** banorë i fshatit **Qytetit Vau-Dejës**. të Njesisë Administrative Vau Dejës të Bashkisë Vau-Dejës me shumën **879.170** (Tetëqind e shtatëdhjetë e nënte mijë e njëqind e shtatëdhjetë) lekë në masën **50%** të vlerës totale të dëmit për të përballuar dëmet e shkaktuara në banesën e tij nga djegia e saj me dt.19.08.2022.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

3. **Efektet:** Krijon lehtësira për përballimin e situatës emergjente të banorit të dëmtuar.
4. **Burimi i financimit :**Fondi i planifikuar në programin “Emergjencat Civile “i cili është miratuar në Buxhetin e Bashkisë sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak Nr.72 dt.23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit të vitit 2022.
5. Ngarkohen Drejtoria e Ekonomike (Sektori i Buxhetit dhe finances) për zbatimin e ketij vendimi.
6. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë mbas shpalljes publike (sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit nr. 139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”i ndryshuar).

KRYETAR

Mark Bishoff

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Adrian Celepja

Miratuar me 22 vota

Vota Pro 22

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 28.09.2022

